

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 29.03.2024*

**29.03.2024
Ora 12:08**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

**Të tjerë: Z. Kristaq Kume, znj. Olta Qejvani, përfaqësues të
Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve.**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme publike, kemi në rend dite dy çështje për shqyrtim:

- Projektvendimi “Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”. Si dhe nga seancat e kaluara kemi:

- Projektvendimin “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, zotin Kristian Luigj Shkreli...”. Këtë pikën e dytë do ta shtyjmë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 29.03.2024*

Vazhdojmë me pikën e parë që ka të bëjë me miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë. Zoti Kume, ju japim fjalën ju, për të paraqitur kërkesën.

Z. P. Kume: Faleminderit zoti Celibashi! Faleminderit ju të gjithëve që merrni pjesë në këtë seancë. Kërkesa për të na paisur ne, nismëtarëve me formularin tip, për grumbullimin të paktën të 20000 zgjedhësve, për të nisur në Kuvendin e Shqipërisë një projektligj, nëpërmjet të cilit do të kërkojmë ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në dispozitat që trajtojnë problemin e përcaktimit të njësisive zgjedhore në të cilat duhet të ndahet vendi për zgjedhjet politike. E kemi ndërmarrë këtë nismë duke pasur parasysh tashmë, ndryshimin e madh të bërë për këtë çështje në Kushtetutën e Shqipërisë në korrik 2020, lidhur me shfuqizimin e dispozitës në të cilën përcaktohej se “ndarja për efekt të procesit zgjedhor të Republikës në njësi zgjedhore, duhej të bëhej duke referuar një prej ndarjeve territoriale administrative të vendit. Për pasojë në Kodin Zgjedhor, u përcaktua ndarja në njësi zgjedhore qark, në 12 njësi zgjedhore. Duke qenë se kjo është një kërkesë e Kushtetutës ishte e pamundur që të ndërhyjm, përveç se duke e amenduar Kushtetutën. Shfuqizimi i saj hapi mundësitë për të ndërhyrë tashmë, kushdo që është i interesuar dhe në këtë rast, të interesuar jemi ne qytetarët e Republikës së Shqipërisë, për të bërë ndryshimin. Ndryshimi sipas propozimit tonë do të çojë në atë që, në qoftë se do të miratohet në Kuvendin e Shqipërisë, Shqipëria në zgjedhjet politike të ndahet në katër njësi zgjedhore, të quajtura nga ne rajone zgjedhore. Kjo gjë propozohet si e tillë pas dhe mbështetur në rezultatet e analizave të bëra për efektin që ka sjellë në rezultatin e procesit zgjedhor, në kuptimin e proporcionalitetit midis vullneteve të shprehura në kutitë e votimit dhe strukturës politike të parlamentit që del në përfundim të procesit zgjedhor. Kjo si rezultat i atij fakti që na

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 29.03.2024*

ka treguar se ky parim, parimi i proporcionalitetit nuk funksionon në mënyrë reflektive. Ashtu si shpesh ka dalë që çdokush që ka dashur dhe e ka trajtuar këtë problem është konsideruar edhe si faktor i cili ka bërë që pesha e votës së zgjedhësve të ndodhur në njësi të ndryshme zgjedhore siç është njësia e Kukësit, e Dibrës me atë të Tiranës që merret zakonisht për krahasim, nuk është e njëjtë në kuptimin e forcës që ajo ka për t'u shndërruar në mandat deputeti. Ndërkohë, përveç kësaj në këtë projektligj, në qoftë se ne do të kemi mbështetjen qytetare ashtu siç e kërkon ligji dhe kushtetuta, ne kemi parashikuar edhe votimin me lista të hapura. Mundësi e cila është si e tillë e përcaktuar nga ajo çfarë shprehet në dispozitën përkatëse të kushtetutës. Mënyra se si ne e kemi trajtuar në draft, kemi pasur si synim kryesor që të realizojmë maksimumin e mundësive që jep vota parapëlqyese e zgjedhësve për deputetët e nesërm të Kuvendit të Shqipërisë. Kjo gjë do të thotë që, mekanizmi i shfaqur është po ai mekanizëm që e kemi kërkuar 22600 zgjedhës dhe e kemi nisur tani si projektligj në Kuvendin e Shqipërisë për rastin e zgjedhjes së anëtarëve të këshillave bashkiakë. Sipas atij projektligji të nisur në Kuvendin e Shqipërisë dhe këtij që kemi formuluar sot, tashmë për zgjedhjet e Kuvendit, ndarja e mandateve të kandidatëve të listës së një subjekti politik, të realizohet vetëm pasi këta të rirenditen sipas votave parapëlqyese. Qytetari po ashtu të ketë të drejtë të japë votën parapëlqyese për cilindo nga kandidatët e listës. Kjo do të thotë që kemi përdorur atë mundësi që jep kushtetuta në të cilën thuhet që lista të mund të hapet jo me pak se 2/3, gjë që ne i trembemi faktit, që mund të përdoret si mundësi për të mos e hapur listën 100 %, por për të lënë të hapur vetëm 2/3 e listës. Së fundi, duke i bërë bashkë të dyja, propozimin tonë për ndarjen e Shqipërisë në katër rajone zgjedhore dhe votimin me lista të hapura edhe në qoftë se partitë politike do të përdorin këtë mundësi që u jep kushtetuta, të hapin vetëm 2/3 e listës, praktikisht ne do të kemi mundësi të përfitojmë nga vota parapëlqyese e zgjedhësve, pra ta bëjmë reale atë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 29.03.2024*

ç'ka është rënë dakord dhe tani është e fiksuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Unë ju falenderoj për mirëkuptimin që keni treguar zoti Celibashi, sapo e kemi biseduar në parim një gjë të tillë, ju më keni nxitur që ta bëj sa më shpejt që të jetë e mundur. Natyrisht kemi përpara një pengesë që mund të na shfaqet shumë shpejt si e tillë dhe të na pengojë të gjithë atë që ne duam të realizojmë dhe që ka të bëjë me rekomandimin e Komisionit të Venecias në “Kodin e Praktikave të Mira”, për çështje zgjedhore, ndër të cilat thuhet që “çështje të rëndësishme nuk duhet të jenë objekt ndryshimi në legjislacion një vit përpara ditës së zgjedhjeve”. Në këto çështje të rëndësishme e përmend në mënyrë fare të qartë “ndarjen në njësi zgjedhore”, e konsideron si një gjë që nuk duhet të bëhet një vit përpara ditës së zgjedhjeve. Ne shpresojmë, nisur nga fakti që janë të shumtë ata që e kërkojnë një ndryshim të tillë, jo vetëm qytetarë, por edhe partitë politike po ashtu. Shpresojmë se shumica duhet të jetë në të njëjtat valë me ne, për sa kohë që praktikisht e ka të zbatuar këtë ndarje, por për një arsye tjetër, siç është ligji “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin social”. Besojmë se do të arrijmë ta realizojmë deri në fund dhe nesër në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 2025 të votohet për katër njësi zgjedhore me lista të hapura, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Kume! Atëherë, ne vlerësojmë se kërkesa e komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të përbërë nga: zoti Kristaq Kume, përfaqësues i Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, zonja Olta Qejvani, zgjedhës, përfaqësues i Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, zoti Linert Lirëza, zgjedhës, përfaqësues i Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve dhe zonja Mirjam Reçi, zgjedhëse dhe përfaqësuese e Qendrës për Zhvillim të Shoqërisë Civile – Durrës, është në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 29.03.2024*

parashikimet e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 54/2019

“Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, ndaj vendosim:

- Miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve, sipas lidhjes që do t'i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Procedura për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të realizohet brenda një periudhe tre mujore nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Mirë faleminderit! Çështje të tjera nuk kemi..,

Z. K. Kume: Faleminderit ju!

Z. I. Celibashi: Seanca mbyllet!

Vendimi nr. 30

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

